



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primiçeno:	16.09.2024	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtëpia Dodatak
05-020/04-45896		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Nenet 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS shpallë:

**NJOFTIM PUBLIK
PËR DËRGIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTAR NË KOMISIONIN VLERËSUES PËR
FINANCIMIN E PROJEKTEVE TË OJQ-VE**

Njoftohen përfaqësuesit e Organizatave të shoqërisë civile se mund ti dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit Vlerësues i cili do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të financimit të projekteve, të OJQ-ve të cilat do të aplikojnë sipas thirrjes publike për aplikim me Nr.05-453/01-40099të datës 12.08.2024.

Ky Komision do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin e projekteve të OJQ-ve për zbatimin e objektivave Kulturore organizimin e Festivalit të këngës për fëmijë „Lipjani Këndon 2024” sipas thirrjes publike për aplikim me Nr.05-453/01-40099të datës 12.08.2024. Ku do të plotësohet me:

- Një përfaqësues nga OJQ-të
- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet t'i drejtohen Drejtoratit për Kultur, Rini dhe Sport dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për shërbime me qytetar sporteli nr. 1 dhe 2 më së largu deri me datë 18.09.2024.

Lipjan, më 16/09/2024

Drejtoresha e DKRS-së
Anila Reçica-Llugiqi

